



## Zhvillimet e standardeve të KPT nga policia gjatë ndalimit dhe paraburgimit

*Pjesë nga raporti i 12-të i Përgjithshëm,  
publikuar në vitin 2002*

33. Funkcionimi i mirë i shoqërisë kërkon që policia të ketë pushtetin të pyesë, të ndalojë përkohësisht dhe të dëgjojë persona të dyshuar shkelje penale si dhe kategori personash të tjerë. Megjithatë, këto kompetenca përmbajnë një rrezik përbërës frike dhe keqtrajtimesh fizike. Thelbi i punës së KPT-së qëndron në kërkimin e mjeteve për të kufizuar këtë rrezik në minimumin absolut por pa penguar në mënyrë të panevojshme policinë në ushtrimin e funksioneve të saj. Në disa Shtete të tjera, zhvillime inkurajuese janë vënë re në fushat e ndalimit nga policia; megjithatë, konstatimet e bëra nga KPT-ja vënë ende në dukje domosdoshmërinë e një vigjilence të përhershme.

34. **Marrja në pyetje e personave të dyshuar për një shkelje penale** është një aktivitet i specializuar që kërkon një formim të veçantë për t'u zhvilluar në mënyrë të kënaqshme. Përpara së gjithash, *objektivi i saktë i marrjes në pyetje* duhet të jetë i shprehur qartë: ky objektivi duhet të jetë ai i marrjes së informacioneve të sakta dhe të besueshme me qëllim për të zbuluar të vërtetën lidhur me çështjet që përfshihen në hetim dhe jo për të marrë pohime, nga një person që prezumohet fajtor, nga ata që e marrin në pyetje. Përveç një formimi të duhur, përpunimi i një kodi të sjelljes për marrjet në pyetje të personave të dyshuar për një shkelje penale do të lehtësojë konsiderueshëm mundësinë e anëtarëve të forcave të rendit për të plotësuar këtë objektivi.

35. Gjatë viteve, delegacionet e KPT-së janë takuar me një numër të konsiderueshëm personash të ndaluar në shtete të ndryshme, të cilët kanë paraqitur pretendime të besueshme lidhur me keqtrajtimet fizike që kishin vuajtur ose frikësimet ose kërcënimet e lëshuara nga policët, me qëllim për të marrë pohime gjatë marrjes në pyetje. Është e qartë se një sistem penal që mbështetet në provën me pohim, mund t'i nxisë hetuesit – shpesh nën presion për të pasur rezultat – të përdorin forcën fizike ose psikologjike. Me qëllim për të parandaluar torturën dhe forma të tjera keqtrajtimesh, është thelbësore të zhvillohen metoda hetimi penal që bëjnë të mundur përdorimin e pohimeve ose informacionet e marra me anë të marrjes në pyetje për të zbuluar fajin.

36. **Regjistrimi elektronik (domethënë audio dhe/ose video) i dëgjimeve nga policia** përfaqëson, për personat e ndaluar, një garanci plotësuese kundër keqtrajtimeve. KPT-ja vëren me kënaqësi që futja e sistemeve të tilla parashikohet në shumë vende. Sisteme të tilla mund të ofrojnë një përmbledhje të plotë dhe autentike të procesit të hetimit dhe kështu, të lehtësojë së tepërmi hetimet në rast pretendimesh për keqtrajtime. Kjo është si në interes të personave që janë keqtrajtuar nga policia ashtu dhe në atë të policisë që përballet me pretendime të pabazuara për keqtrajtime fizike ose presione psikologjike. Regjistrimi elektronik i dëgjimeve nga policia gjithashtu kufizon mundësinë, për personat nën shqyrtim, për të mohuar në mënyrë të rreme se ata kishin dhënë deklaratat të veçanta.

37. Më tepër se një herë, dhe më shumë se në një Shtet, Komiteti ka zbuluar **dhoma të rezervuara për marrjet në pyetje** të cilat ishin tepër të frikshme: për shembull, dhoma me tapiceri të zezë të pajisura me projektorë të drejtuar nga karrigia ku ulej personi i marrë në pyetje. Ambjente të tilla nuk kanë vend në institucionet e policisë.

Dhomat e rezervuara për marrjet në pyetje duhet të jenë të ndriçuara, të ngrohura, dhe të ajrosura dhe për më tepër, duhet të jenë të pajisura në mënyrë të tillë që t'u lejojnë të gjithë pjesëmarrësve në procesin e marrjes në pyetje të ulen në karrige të llojit dhe konfortit të njëjtë. Polici që procedon me dëgjimin nuk duhet të jetë në një situatë prej sunduesi (për shembull, në një vend të ngritur) ose i vendosur larg të dyshuarit. Për më tepër, lysterja dhe mobilimi i dhomave do të duhet të jetë i përshtatshëm.

38. Në disa Shtete, KPT-ja është gjendur përballë me praktikën e **mbylljes së syve** të personave të ndaluar nga policia, veçanërisht gjatë marrjes në pyetje. Delegacionet e KPT-së kanë dëgjuar disa shpjegime – shpesh kontradiktore – në lidhje me arsyen e kësaj praktike. Është e qartë për KPT-në, pasur parasysh informacionet e mbledhura gjatë viteve, që pothuaj në të shumtën e rasteve, personat i kanë sytë e lidhura për të shmangur identifikimin e forcave të rendit që i keqtrajtojnë. Edhe në rastet kur nuk ka keqtrajttime fizike, fakti i lidhjes së syve të një personi të ndaluar – dhe në veçanti një personi që është duke u pyetur – është një lloj shtypje efektet e së cilës tek personi do të shfaqen si një trajtim i keq psikologjik. Komiteti rekomandon që të ndalohet shprehimisht praktika që ka të bëjë me lidhjen e syve të personave të ndaluar nga policia.

39. Nuk është e rrallë që KPT-ja të gjejë **objekte të dyshimta** në ambjentet e policisë, si shkopinj druri, shkopinj fshese, shkopinj bejzbolli, shufra hekuri, pjesë kablli elektrik, imitime armësh zjarri dhe thika. Prania e objekteve të tilla, në shumë raste i ka bërë të besueshme pretendimet e mbledhura nga delegacionet e KPT-së sipas të cilave personat e ndaluar në këto institucione ishin kërcënuar dhe/ose rrahur me këto lloje objektesh.

Një shpjegim i dhënë zakonisht nga policët në lidhje me këto objekte është se bëhet fjalë për objekte të sekuestruara nga të dyshuarit, dhe që shërbenin si element prove. Fakti që këto objekte janë pa etiketë dhe shpeshherë gjenden të shpërndarë në ambjente (ndonjëherë mbrapa perdeve ose dollapeve) lë vend vetëm për dyshim ndaj këtij shpjegimi. Për të shmangur spekulimet lidhur me një sjellje jo korrekte të policëve dhe për t'i zhdukur burimet e rrezikut të mundshëm për personelin si dhe për personat e ndaluar, objektet e sekuestruara si prova duhet të jenë gjithmonë të etiketuara, në inventar dhe të ruajtura në një vend veçanërisht të rezervuar për objektet e sekuestruara. Të gjitha objektet e të njëjtit lloj me ato të përshkruara më sipër duhet të hiqen nga ambjentet e policisë.

40. Që nga fillimi i veprimtarive të tij, KPT-ja ka mbrojtur gjithnjë një treshe të drejtash për personat e ndaluar nga policia: **të drejtat për një avokat, për një mjek si dhe të drejtën për personat e interesuar për të njoftuar një të afërt ose një të tretë për ndalimin e tyre**. Në shumë Shtete, masa janë marrë për të siguruar ose forcuar këto të drejta, nën dritën e rekomandimeve të KPT-së. Më saktësisht, e drejta për një avokat gjatë ndalimit nga policia njihet gjërësisht nga vendet e vizituara nga KPT-ja; në vendet e rralla ku kjo e drejtë nuk ekziston ende, janë duke e parashikuar disa projekte në zhvillim e sipër.

41. Megjithatë, disa vende shfaqin një lloj rezerve për t'i vënë në zbatim rekomandimin e KPT-së, sipas të cilit **e drejta për një avokat** duhet të sigurohet që nga fillimi i ndalimit nga policia. Në disa Shtete, personat e ndaluar nga policia e gëzojnë këtë të drejtë vetëm pas një periudhe të caktuar ndalimi; në Shtete të tjera, kjo e drejtë bëhet efektive vetëm duke filluar nga momenti kur personi i ndaluar është formalisht në kategorinë e «të dyshuarve».

KPT-ja, vazhdimisht, ka nënvizuar se, sipas eksperiencës së saj, është gjatë periudhës që pason menjëherë heqjen e lirisë që rreziku i frikësimit dhe i keqtrajtimit fizike është më i madh. Si pasojë, mundësia, për personat e ndaluar nga policia, për të pasur një avokat gjatë kësaj periudhe përbën një garanci thelbësore kundër keqtrajtimit. Ekzistenca e kësaj mundësie do të ketë një efekt bindës mbi ata që janë të prirur të keqtrajtojnë personat e ndaluar; për më tepër, një avokat është personi i përshtatshëm për të marrë masat e duhura kur personat e ndaluar janë keqtrajtuar realisht. KPT-ja pranon që, me qëllim për të ruajtur interesat legjitime të hetimit policor, përjashtimisht mund të jetë e nevojshme që ushtrimi i së drejtës për avokat të zgjedhur nga personi i ndaluar të vonohet për një periudhë të caktuar kohe. Megjithatë, kjo nuk duhet të çojë në një mohim të plotë të së drejtës për avokat gjatë periudhës në fjalë. Në këtë rast, duhet siguruar e drejta për një avokat tjetër.

E drejta për avokat nënkupton të drejtën për t'u takuar me të pa dëshmitar. Parimisht duhet që personi i interesuar, të përfitojë gjithashtu nga prania e një avokati gjatë seancës së pyetjeve të zhvilluar nga policia. Natyrisht, kjo nuk duhet ta pengojë policinë të dëgjojë një person të ndaluar për çështje urgjente, dhe në mungesë të një avokati (i cili nuk mundet të jetë menjëherë i disponueshëm) as të përjashtojë zëvendësimin e një avokati i cili do të ndalonte mbarëvajtjen e seancës së pyetjeve.

KPT-ja ka theksuar se e drejta për avokat nuk duhet të rezervohet vetëm për personat e dyshuar për shkelje penale por duhet të zbatohet dhe për ata që detyrohen të dorëzohen ligjërisht – ose të qëndrojnë – në një institucion policor, për shembull si «dëshmitarë».

Për më tepër, që e drejta për avokat të jetë plotësisht efektive në praktikë, masat e përshatshme duhet të merren për personat që nuk janë në gjendje të paguajnë një avokat.

42. Personat e ndaluar nga policia duhet të gëzojnë të drejtën, formalisht të njohur, **për tu mjekuar nga një mjek**. Me fjalë të tjera, gjithmonë duhet thirrur pa afat një mjek nëse një person kërkon një vizitë mjekësore; policët nuk duhet të përpiqen t'i filtrojnë kërkesa të tilla. Për më tepër, e drejta për tu mjekuar nga një mjek duhet të përfshijë përfitimin nëse një person i ndaluar e dëshiron, për një vizitë nga një mjek të zgjedhur nga vetë ai (përveç vizitës së bërë nga mjeku i thirrur nga policia).

Të gjitha vizitat mjekësore të personave të ndaluar nga policia duhet të zhvillohen jashtë dëgjimit të anëtarëve të forcave të rendit dhe, përveç një kërkesë të kundërt të mjekut të interesuar në një rast të veçantë, jashtë vështrimit të tyre.

Është e rëndësishme gjithashtu që personat e liruar pas një ndalimi nga policia, pa u paraqitur përpara një gjyqtari, të kenë të drejtë të kërkojnë drejtpërdrejtë një vizitë/certifikatë nga një mjek ligjor i njohur zyrtarisht.

43. E drejta për një person i ndaluar nga policia **për të informuar një të afërt ose një të tretë për situatën e tij**, parimisht, duhet të garantohet që nga fillimi i heqjes së lirisë së tij. Sigurisht, KPT-ja pranon që ushtrimi i kësaj të drejte mund t'i nënshtrohet disa përjashtimeve, me qëllim për të mbrojtur interesat legjitime të hetimit policor. Megjithatë këto përjashtime duhet të përcaktohen dhe kufizohen qartë në kohë dhe ushtrimi i këtyre përjashtimeve duhet të rrethohet nga garancitë e duhura (për shembull, çdo vonesë për njoftimin e një të afërmi ose të një personi tjetër duhet të depozitohet me shkrim me arsytet që e kanë motivuar, dhe i nënshtrohet më parë një funksionari të lartë të policisë që nuk ka asnjë lidhje me çështjen në fjalë ose një prokurori).

44. Të drejtat e personave të privuar nga liria nuk do të kenë asnjë vlerë në rast se këta persona nuk e njohin ekzistencën e tyre. Si pasojë, është e detyrueshme që personat e ndaluar nga policia të

jenë **shprehimisht të informuar për të drejtat e tyre**, pa afat dhe në një gjuhë që ata kuptojnë. Për këtë, një formular që saktëson në mënyrë të thjeshtë të drejtat duhet t'u shpërndahet rregullisht personave të ndaluar nga policia, që nga fillimi i ndalimit të tyre. Për më tepër, personave të interesuar u duhet kërkuar nënshkrimi i një deklaratë e cila dëshmon se ata janë mirëinformuar për të drejtat e tyre.

45. KPT-ja ka vënë në pah, shpeshherë, **rolin e autoriteteve gjyqësore** në luftën kundër keqtrajtimit nga policia.

Për shembull, të gjithë personat e ndaluar nga policia të cilët parashikohen të paraburgosen duhet të paraqiten fizikisht përpara gjyqtarit kompetent për të marrë vendimin; por nuk ndodh kështu në të gjitha vendet e vizituara nga KPT-ja. Paraqitja e personit përpara gjyqtarit do t'i lejojë atij ose asaj që është keqtrajtuar të bëjë një ankim atëherë kur nevojitet. Për më tepër, edhe në mungesë të një ankimi formal, gjyqtari mund të marrë masat e duhura në rast se ka tregues të tjerë për keqtrajtime (për shembull, plagosje të dukshme; ose nga pamja apo sjellja e përgjithshme e një personi).

Sigurisht, gjyqtari duhet të marrë masat e duhura në rast se ka tregues për keqtrajtime nga policia. Në lidhje me këtë, sa herë që persona të dyshuar për një shkelje penale paraqiten përpara një gjyqtari pas paraburgimit nga policia me pretendimin se janë keqtrajtuar, gjyqtari duhet t'i depozitojë pretendimet me shkrim, të urdhërojë menjëherë një ekspertizë mjeko-ligjore dhe të marrë masat e nevojshme me qëllim që pretendimet të jenë të verifikuara ashtu si duhet. Këshillohet të ndiqet kjo procedurë pavarësisht se personi i interesuar ka ose jo plagë të jashtme të dukshme. Për më tepër, dhe në mungesë të një pretendimi për keqtrajtim të shprehur qartë, i takon gjyqtarit të kërkojë një ekspertizë mjeko-ligjore kur ka arsye të tjera për të besuar se një person që paraqitet para tij mund të ketë qenë viktimë e keqtrajtimit.

Shqyrtimi i zellshëm nga autoritetet gjyqësore dhe autoritetet e tjera kompetente i të gjitha ankimeve për keqtrajtim bërë kundër anëtarëve të forcave të rendit, dhe nëse nevojitet, dhënia e një dënimi të duhur do të kenë një efekt bindës tepër të fortë. Në të kundërt, në rast se këto autoritete nuk marrin masa efektive për trajtimin e ankimeve të paraqitura, ata që janë të prirur për të përdorur forcën ndaj personave të ndaluar, fare lehtë do të mendojnë se mund të veprojnë pa u dënuar.

46. **Marrje në pyetje plotësuese nga policia të personave të paraburgosur** mund të jenë gjithashtu të nevojshme. Në këto raste KPT-ja mendon se në perspektivën e parandalimit të keqtrajtimit, nuk preferohet që marrja në pyetje të zhvillohet në institucionet e vuajtjes së dënimit, por në ambjentet e policisë. Ritransferimi i të ndaluarëve në paraburgim për dëgjim plotësues duhet të kërkohet dhe autorizohet kur kjo është krejt e paevitueshme. Është e qartë se në rrethana të jashtëzakonshme kur një i ndaluar ritransferohet në paraburgim, ai duhet të gëzojë tre të drejtat e parashtruara në paragrafet 40 deri në 43.

47. Paraburgosja nga policia është (ose më mirë duhet të jetë) relativisht e shkurtër. Megjithatë, **kushtet e paraburgosjes në qelitë e policisë** duhet të mbushin disa *kushte elementare*.

Të gjitha qelitë e policisë duhet të jenë të pastra dhe të një madhësie të arsyeshme<sup>1</sup> pasur parasysh numrin e personave që mund të qëndrojnë aty, dhe duhet të kenë një ndriçim të përshtatshëm (domethënë të mjaftueshëm për të lexuar jashtë periudhave të pushimit); është e preferueshme që selitë të marrin dritën natyrale. Për më tepër, qelitë duhet të rregullohen në mënyrë të tillë që të bëjnë të mundur çlodhjen (për shembull një karrige ose një ndenjësë të fiksuar), dhe

---

<sup>1</sup> Përsa i përket madhësisë së qelisë të policisë, shihni gjithashtu paragrafin 43 të Raportit të Përgjithshëm të 2-të (CPT/Inf (92) 3).

personat e detyruar të kalojnë natën në paraburgim duhet të disponojnë një dyshek dhe mbulesa të pastra. Personat e ndaluar nga policia duhet të kenë mundësi të shkojnë në banja të pastra dhe të kenë mundësi të lahen. Ato duhet të kenë mundësi të përdorin në çdo moment ujën e pijshëm dhe të kenë për të ngrënë në momentet e përshtatshme, përfshirë këtu një vakt të plotë të paktën çdo ditë (pra diçka më të plotë sesa një sanduiç). Personat e ndaluar nga policia gjatë 24 orësh ose më tepër duhet, nëse është e mundur, të kenë mundësi të dalin një herë në ajër të pastër.

Shumë ambiente policie që vizitohen nga KPT-ja nuk janë në përputhje me normat minimale. Kjo është veçanërisht e dëmshme për personat të cilët paraqiten më vonë përpara një autoriteti gjyqësor; shpeshherë, disa persona paraqiten përpara gjyqtarit pasi kanë kaluar një ose disa ditë në qeli që nuk i përgjigjen normave të kërkuara dhe shumë të pista, pa pasur mundësi as të pushonin, as të ushqeheshin në mënyrë korrekte, dhe as të laheshin.

48. Detyrimi për kujdes që i ngarkohet policisë për personat që ajo ndalon, përfshin kujdesin *për sigurinë e tyre dhe integritetin fizik*. Si pasojë, një mbikqyrje e përshtatshme e zonave të paraburgimit është një përbërës i rëndësishëm i detyrimit të marrjes në ngarkim nga policia. Masat e duhura duhet të merren për t'i garantuar personave të ndaluar nga policia që të kenë mundësi të kontaktojnë në çdo moment personelin e mbikqyrjes.

Disa herë, delegacionet e KPT-së kanë konstatuar se qelitë e policisë ndodheshin shumë larg nga zyrat ose tavolinat ku policët mblidheshin zakonisht dhe se ato nuk kishin ndonjë paisje (sidomos një sistem thirrje) me anë të të cilit personat e ndaluar të mund të thërrisnin policët. Në kushte të tilla, ekziston një rrezik i konsiderueshëm se nuk mund të ndërhyhet në kohën e duhur në rast incidentesh të ndryshme (dhunë midis personave të ndaluar, tentative vetëvrasje, zjarr, etj).

49. KPT-ja ka shprehur gjithashtu rezerva në lidhje me praktikën e vëzhguar në këto vende, sipas së cilës çdo shërbim operacional (kundër drogës, kriminalitetit i organizuar, luftës kundër terrorizmit) dispononte, brenda një institucioni policor, zonën e tij të mbikqyrjes të drejtuar nga policët e shërbimit të interesuar. Komiteti konsideron se kjo praktikë duhej braktisur, për të vendosur *një zonë qendrore qelish*, të drejtuar nga një grup i veçantë policësh me formim të veçantë për mbikqyrje dhe marrje në ngarkim të personave të ndaluar. Kjo do të ishte pa dyshim shumë përfituese nga pikëpamja e parandalimit të keqtrajttimeve. Nga ana tjetër, lirimi i shërbimeve operacionale nga këto detyra mund të sillte avantazhe përsa i përket menaxhimit dhe logjistikës.

50. Së fundi, inspektimi i ambienteve të policisë nga një autoritet i pavarur mund të japë një kontribut të madh për parandalimin e keqtrajttimeve të personave të ndaluar nga policia, dhe përgjithësisht, të ndihmojë në garantimin e kushteve të pranueshme të paraburgimit. Për të qënë plotësisht efikas, vizitat e bëra nga një autoritet i tillë duhet të jenë njëherësh të rregullta dhe të befasishme dhe ky autoritet duhet të ketë mundësi të takohet pa dëshmitar me personat e ndaluar. Për më tepër, ai duhet të shqyrtojë të gjitha çështjet lidhur me personat e ndaluar: regjistrimin e ndalimit, informacionet e dhëna nga persona të ndaluar lidhur me të drejtat e tyre dhe ushtrimin efektiv të tyre (në veçanti të tre të drejtave të ekspozuara në paragrafët 40 deri në 43), respektin e rregullave për marrjen në pyetje të personave të dyshuar për shkelje penale, si dhe kushtet materiale të paraburgimit.

Konstatimet e autoritetit të sipërpërmendur duhet t'i përcillen jo vetëm policisë por dhe një autoriteti tjetër, të pavarur nga policia.